REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE
BORDI I APELIT

Nr. 417 Prot.

Tiranë, më 26.01.2026

Lënda: Informim mbi publikimin e thirrjes për aplikim në Bordin e Apelit

Drejtuar: Znj. Rudina Bollano,
Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar,

Në kuadër të plotësimit të përbërjes së Bordit të Apelit, në cilësinë e sekretares ju vë në dijeni se është përgatitur thirrja publike për shprehje interesi për aplikim, e cila publikohet në faqen zyrtare të institucionit në përputhje me kuadrin ligjor.

Bordi i Apelit është një organ i krijuar në bazë të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, që shqyrton çështjet e zgjidhjes së konflikteve që lidhen me pronësinë dhe të drejtat mbi objektet e PI-së. Organizimi, funksionimi dhe përcaktimi i masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit, rregullohet me vendimin nr. 752, datë 19.12.2018 "*Për Miratimin e Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale*" të Këshillit Ministrave.

Bordi i Apelit përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët dy janë punonjës të DPPI-së dhe tre anëtarë të jashtëm të fushës së PI-së që emërohen nga Këshilli Mbikqyrës me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, për një periudhë 1 vjeçare.

Për shkak se mandati 1-vjeçar i tre anëtarëve të jashtëm të Bordit të Apelit ka përfunduar në Dhjetor 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, bazuar në nenin 2, pika 4 e Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 752, datë 19.12.2018 "*Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit*

të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale", ka shpallur thirrjen për tre vende vakante për anëtarë të jashtëm të Bordit të Apelit, për vitin kalendarik 2023.

Në kushtet kur nuk ka pasur asnjë shprehje interesi për të kandiduar për vendet vakante të anëtarëve të jashtëm të Bordit të Apelit përgjatë gjithë vitit 2023/2024 dhe vitit 2025, DPPI ka përsëritur shpalljen në faqen zyrtare për vitin **2026 (www.dppi.gov.al)** duke lënë si afat datën **26 Shkurt 2026** për dorëzimin e aplikimeve. Pavarësisht shpalljes së përsëritur nga DPPI, asnjë kandidat nuk ka shprehur interes për ndonjërin prej vendeve vakante të anëtarëve të jashtëm.

Për sa më sipër ju lutem miratimin tuaj dhe marrjen e masave për publikim duke pasur afat 1 muaj për dorëzimin e aplikimeve.

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I BORDIT TË APELIT

Fatjona Xhaja

Bulevardi
"Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri(AL)
Web www.dppi.gov.al E-mail: info@dppi.gov.al